



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:093718

Datë: 29.10.2021

Numri i dokumentit: 02340225

C.nr.1001/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm gjyqtari Bekim Salihu, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditëses L.Sh. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson me autorizim av.Besmir Rrahmani nga Ferizaj, kundër të paditurës Qendra e Mjekësisë Familjare në Ferizaj, rr."Ramadan Rexhepi" p.nr., në çështjen juridike pagesën e pagave jubilarë, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor me dt.29.10.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses L.Sh. nga Ferizaj, si e bazuar.

II. DETYROHET e paditura Qendra e Mjekësisë Familjare në Ferizaj, që paditëses t'ia paguaj shumën neto prej 891.78€ (tetëqind e nëntëdhjetë e një euro e shtatëdhjetë e tetë cent) në emër të dy pagave jubilarë, me kamatë ligjore prej 8% prej datës 18.05.2021 me rastin e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 124.00€, të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja me datë 18.05.2021 ka ushtruar padi ndaj të paditurës, me kërkesë për realizimin e pagave jubilarë me përvojë pune 20 vite, ku me anë të padisë ka theksuar se tek e paditura është në marrëdhënie të punës në pozitën infermiere dhe ka përvojë të punës prej 20 vite, por edhe për kundër kërkesës me shkrim e paditura nuk ia ka paguar dy pagat jubilarë në shumë prej 891.78€, ashtu siç e ka pasur për detyrim sipas nenit 17 të Kontratës Kolektive Sektoriale, pasi që pagën mujore të fundit paditësja e ka pasur 445.89€, siç vërtetohet përmes listës së pagave.

Ka kërkuar nga ana e gjykatës që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar me kamat ligjore prej 8% si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

E paditura me anë të përgjigjes në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar për faktin se edhe përkundër Marrëveshjes Kolektive Sektoriale SHSKUK-ja, nuk ka ndarë fond të veçantë për pagesën e pagave jubilarë, si rezultat i të cilës e paditura nuk ka mjete financiare për të bërë këto lloj pagesa nga se Qeveria e Kosovës si nënshkruese e saj nuk ka ndarë mjete buxhetore për këto pagesa.

Andaj ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pa bazuar .

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, shkresave të tjera të lëndës, përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, e në kuptim të nenit 8 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mes palëve se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në pozitën si infermiere dhe ka përvojë të punës prej 20 vite, por kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë dhe lartësia e saj.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë të dy pagave jubilarë, në shumën prej 891.78€, ka marr për bazë listën e pagave të bashkangjitur nga paditësja, ku shihet se paga mujore neto është 445.89€, e cila përputhet me lartësinë e aprovuar të kërkesëpadisë.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive Sektoriale të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës, për punëmarrësin dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës siç parashihet me nenin 90 par.4 të Ligjit të Punës, e cila është nënshkruar nga të dy palët dhe në nenin 17 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se të punësuarit me rastin e pensionimit gëzojnë të drejtën e kompensimit të tri pagave jubilarë dhe tri pagave për përcillje në pension sipas kushteve që janë të përcaktuar për secilin rast veç e veç.

Në nenin 17 par.3 pika 3.1. 3.2 dhe 3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale është paraparë që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të një pagë mujore, për 20 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej dy paga mujore, për 30 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë prej tri pagave mujore, punëdhënësi i fundit është ai që i paguan shpërblimet jubilarë, shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf, çka do të thotë se e paditura është dashur që me rastin e arritjes së përvojës së punës të punëmarrëses-paditëses prej 20 viteve t'ia paguaj dy paga neto nga 891.78€, sa ka qenë kërkesa, brenda një muaji, nga dita

e arritjes së këtij kushti të cilin paditësja e ka plotësuar, siç shihet nga lista e pagës ku paditësi ka përvojë të punës prej 20 viteve .

Sa i përket kundërshtimit të paditurës se kërkesëpadia e paditëses duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka pasur fonde të veçanta që ti përmbushë këto detyrime, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 4 të kësaj kontrate e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive sektoriale dhe me kohë të planifikojë buxhetin për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuara për këto raste, andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësja.

Gjykata në lartësinë e aprovuar të kompensimit të dy pagave jubilarë ku paditëses, i ka njohur të drejtën e kamatës prej 8% nga dita 18.05.2021 deri në pagesën definitive në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Andaj nga arsyet e lartcekura gjykata duke u bazuar në nenin 398 lidhur me nenin 143 të LPK-së e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452 të LPK-së, ku obligohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 124€, dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104€, kurse në emër të taksës gjyqësore për padi shumë prej 20€.

Nga sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
C.nr.1001/21, me datën 29.10.2021**

**Gjyqtari
Bekim Salihu**

KËSHILLA JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.